

**RI-SHPALLJA E VENDEVE TË LIRA TË PUNËS**

Tabela .1

Nr.	Pozicioni i punës	Struktura e interesuar/ Forca	Vendi ku ndodhet	Lloji i kontratës së punës	Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve		Afati i aplikimit	
					Me dosje	Intervista	Fillimi	Mbarimi
1	<b>Specialist</b>	Reparti Ushtarak nr.6601	Tiranë	Pa afat	Po	Po	14.12.2022	20.12.2022
2	<b>Specialist</b>	Reparti Ushtarak nr.6601	Tiranë	Pa afat	Po	Po	14.12.2022	20.12.2022
3	<b>Specialist</b>	Reparti Ushtarak nr.6601	Tiranë	Pa afat	Po	Po	14.12.2022	20.12.2022
4	<b>Specialist</b>	Reparti Ushtarak nr.6601	Tiranë	Pa afat	Po	Po	14.12.2022	20.12.2022

Formulari nr. 1

<b>1.Pozicioni i punës:</b> Specialist, në Sektorin Operacional të Sigurisë Kibernetike, në Njësinë Ushtarake të Sigurisë Kibernetike.
<b>2. Kodi i pozicionit:</b> N/A
<b>3. Reparti/Institucioni:</b> Reparti Ushtarak Nr.6601, Shtabi i Përgjithëm i Forcave të Armatosura.
<b>4. Vendi:</b> Tiranë
<b>5. Paga:</b> VKM nr.187, datë 08.03.2017, i ndryshuar
<b>6. Lloji i kontratës së punës:</b> Pa afat
<b>7. Data e fillimit të aplikimit:</b> 14.12.2022
<b>8. Data e mbylljes së aplikimit:</b> 20.12.2022
<b>9. Mënyra e aplikimit:</b>  Për të aplikuar kandidatët duhet të plotësojnë formularin e aplikimit, të cilin do ta gjejnë në faqen e internetit të Ministrisë së Mbrojtjes, në adresën <a href="http://www.mod.gov.al">www.mod.gov.al</a> . Formulari pasi plotësohet, së bashku me dokumentacionin përkatës, do të dërgohet në:

*Drejtorinë e Miradministrimit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve*

*Ministria e Mbrojtjes, Rruga e Dibrës*

*Tiranë*

## **10. Dokumentet e aplikimit:**

Aplikantët duhet të paraqesin dokumentet e mëposhtme:

- kërkesën;
- formularin e aplikimit;
- fotokopje të kartës së identitetit;
- diplomën e shkollës së lartë të noterizuar sëbashku me listë notash;
- fotokopje të patentës nëse ka;
- dëshmi profesioni nëse ka;
- certifikatë ose dëshmi të gjuhëve të huaja
- raport mjekësor;
- fotografi me përmasa 4x6, 2 copë dhe 9x12 2 copë;
- dëshmi penaliteti;
- vërtetim nga gjykata;
- vërtetim nga prokuroria;
- librezë pune;
- jetëshkrimin (CV)
- Letër motivimi
- formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në faqen e internetit të MM-së në adresën elektronike [www.mod.gov.al](http://www.mod.gov.al).(linku: *Baza ligjore/Akte ligjore/ Integriteti i personave që ushtrojnë funksione publike/formulari i vetdeklarimit*)

## **11. Kërkesat e përgjithshme të pozicionit të punës:**

- a) të ketë shtetësinë shqiptare;
- b) të jetë jo më pak se 18 vjeç;
- c) të gëzojë zotësi të plotë për të vepruar;
- d) të plotësojë kërkesat për llojin dhe nivelin arsimor, si dhe të zotërojë aftësitë profesionale të domosdoshme, për vendin përkatës të punës, sipas kritereve të miratuara;
- ç) të jetë i aftë për punë nga ana shëndetësore;
- e) të mos jetë i/e dënuar me burg me vendim gjykate të formës së prerë për kryerje të një krimi;
- dh) të mos jetë marrë masa disiplinore me largim nga puna, brenda 1 viti nga data e aplikimit.

## **12. Kërkesat specifike të pozicionit të punës:**

- a. **Grada/Titulli:** Civil/Specialist (për sistemet e Sigurisë kibernetike)
- b. **Arsimi :** Të ketë përfunduar ciklin e I-rë bachelor në Fakultetin e Mbrojtjes dhe të Sigurisë, në Akademinë e Forcave të Armatosura, për Teknologji Informacioni dhe Komunikimi në Fushën e Mbrojtjes dhe/ose të barasvlefshëm me të në universitetet publike

dhe private brenda dhe jashtë vendit.

- c. **Kualifikimi:** Të zotërojnë diplomë niveli i II-të master profesional/shkencor për Sigurinë Kibernetike, ose të tjera të barasvlershme me të. Të zotërojnë Comp TIA Security + certifikatë për TI profesional.
- d. **Trajnimi:** Të zotërojnë “Certified Information System Security Professional” (CISSP) dhe certifikate për kurse/trajnime në fushën e sigurisë kibernetike.
- e. **Eksperiencia në Punë:** Jo më pak se 3 (tre) vjet eksperiencë në mjediset e sistemeve të komunikimit dhe të informacionit duke përfshirë njohuri mbi organizimin dhe funksionimin e SKI-ve, ndërtimin dhe konfigurimin e tyre.
- f. **Gjuha e huaj:** Anglisht
- g. **Kërkesa të tjera specifike:** Njohje për Linux, Windows dhe Sistemet e Operimit Njohuri mbi metodologjitë forensic të rrjeteve të bazuar në host. Eksperiencë me mjetet dhe teknikat e zakonshme të sigurisë kibernetike. Elementët e politikave efektive të mbrojtjes; Praktikrat më të mira të sigurisë bazuar në host.
- h. **Niveli i certifikatës së sigurisë:** Teper Sekret dhe NATO Secret. Te plotesoje kriteret per tu pajisur me certifikate te sigurimit te personelit, sipas VKM nr.188/2015.

### 13. Përshkrimi i punës:

**Deklarimi i pozicionit:** Detyrat kryesore të specialistit për Sistemet e Sigurisë Kibernetike (Rr. Klasifikuar) janë drejtimi dhe menaxhimi i seksionit. Ai monitoron nëpërmjet platformave apo sistemeve të sigurisë kibernetike të gjithë aktivitetin ditor me bazë 24/7 të përdorueseve të sistemeve të komunikimit dhe informacionit të FA.

#### Detyrat kryesore:

1. Drejton dhe menaxhon seksionin e rrjetit të klasifikuar/pa klasifikuar.
2. Monitoron nëpërmjet platformave apo sistemeve të sigurisë kibernetike të gjithë aktivitetin ditor me bazë 24/7 të përdorueseve të sistemeve të komunikimit dhe informacionit të FA.
3. Detekton në mënyrë pro aktivë kërcënimet kibernetike dhe parandalon, zbut sulmet/kërcënimet kibernetike përpara se ato të arrijnë komprometimin e SKI-ve të MM/FA.
4. Analizon, zbulon dhe lufton në mënyrë të pandërprerë të gjitha llojet e kërcënimeve kibernetike. Vëzhgon për kërcënime dhe rreziqe kibernetike të cilat mund të fshihen në të dhëna përpara se sulmi të kryhet.
5. Mbledh vazhdimisht dhe sa më shumë të dhëna mbi sjelljen, qëllimin dhe metodat e kërcënimeve kibernetike.
6. Organizon dhe analizon të dhënat e mbledhura me qëllim përcaktimin e trendit të mjedisit të sigurisë së organizatës.
7. Raporton në kohë reale mbi kërcënimet e mundshme të detektuar dhe bashkëpunon ngushtë me sektorin e analizës me qëllim zbutjen dhe neutralizimin e kërcënimit aktual.
8. Në rast detektimi të kërcënimeve, zbaton dhe merr masa konkrete për të zbutur dhe bllokuar sulmin e mundshëm.

### 14. Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve:

Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet nga një komision vlerësimi i përbërë nga 3 (tre) veta.

Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve përfshin:

- përzgjedhjen paraprake;
- vlerësimin e dokumenteve të kandidatëve, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të eksperiencës e të trajnimeve, të lidhura me fushën përkatëse;
- intervistën e strukturuar me gojë.

Përzgjedhja paraprake e kandidaturave do të realizohet nga Drejtoria e Miradministrimit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Mbrojtjes, mbi bazën e dokumentacionit të paraqitur nga kandidatët. Njësia e Burimeve Njerëzore verifikon dokumentacionin e aplikantëve, nëse ai është i plotë dhe i saktë, si dhe plotësimin e kërkesave të pozicionit të punës nga ana e tyre dhe përcakton kandidatët që plotësojnë kërkesat e pozicionit. Vetëm kandidatët që plotësojnë kërkesat e pozicionit do të njoftohen për vazhdimin e mëtejshëm të konkurimit.

Konkurimi me kandidatët që plotësonë kërkesat e pozicionit të punës përfshin:

- vlerësimin e dokumenteve të kandidatëve (vlerësimin e arsimimit/kualifikimit, vlerësimin e trajnimit dhe vlerësimin e eksperiencës të lidhura me fushën përkatëse;
- intervistën e strukturuar me gojë.

Vlerësimi i tyre do të bëhet nga komisioni përkatës.

Totali i pikëve të vlerësimit të kandidatëve është 100 (njëqind), të cilat ndahen:

- a. 40 pikë, për vlerësimin e dokumenteve të kandidatëve;
- b. 60 pikë, për intervistën e strukturuar me gojë.

Vlerësimi i dokumenteve të kandidatëve përfshin:

- a. vlerësimin ejetëshkrimin (CV);
- b. vlerësimin e kualifikimeve akademike, profesionale dhe teknike;
- c. vlerësimin e trajnimeve;
- d. vlerësimin e eksperiencave të ngjashme të punës;

Pikët totale të vlerësimit të dokumenteve ndahen, si më poshtë:

- a. jetëshkrimi, 5 pikë;
- b. arsimimi/kualifikimi, 15 pikë;
- c. trajnimi, 5 pikë;
- d. eksperiencia/përvoja në punë, 15 pikë.

Intervista, zhvillohet me gojë me të gjithë kandidatët që janë përzgjedhur gjatë fazës së përzgjedhjes paraprake. Qëllimi i intervistës është të verifikojë aftësitë, motivacionin dhe aspiratat e çdo kandidati, si dhe përputhshmërinë e profilit profesional të kandidatit me pozicionin që do të mbulojë.

Intervista zhvillohet e strukturuar me qëllim që të sigurojë informacion të saktë rreth profilit profesional të kandidatëve. Ajo strukturohet në varësi të pozicionit që punonjësi do të mbulojë

dhe eksperiencës.

Gjatë intervistës kandidatit i drejtohen disa pyetje nga anëtarët e komisionit, përgjigjet e të cilave vlerësohen me pikë. Çdo pyetje ka një sasi të caktuar pikësh, të cilat vlerësohen në varësi të përgjigjes. Në total intervista ka 60 pikë.

Në mbyllje të procesit të vlerësimit, tre kandidatët që kanë marrë më shumë pikë i paraqiten autoriteteve vendimarrëse për miratimin e kandidatit më të përshtatshëm për mbulimin e pozicionit të shpallur.

Me emërimin në pozicionin e punës do të lidhet kontrata individuale e punës.